

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar” është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe nenin 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ky projektligj ka për qëllim përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve të financuara nga buxheti i njësive të qeverisjes qendrore dhe vendore, të ndërtimeve për qëllime publike në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Ndërkohë, synohet dhe qartësimi i mëtejshëm i aktit nënligjor që referohet për qëllim të përcaktimit të çmimit të shitjes për metër katror në kuadër të vlerësimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Me anë të këtij ndryshimi ligjor synohet të lehtësohen investimet publike në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, me qëllim që të mundësohet realizimi më i shpejtë i projekteve me rëndësi të veçantë për komunitetin, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm social. Gjithashtu, synohet të sigurohet një referencë më e saktë dhe konsistente për çmimet e shitjes, duke shmangur paqartësitë që mund të çenojnë zbatimin e barabartë të llogaritjes së detyrimeve tatimore.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projekt-akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Aktualisht, në bazë të nenit 27, pika 3, shkronja a), për ndërtimet për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 (dy) deri 4 (katër) për qind e saj.

Ky projektligj është hartuar me qëllim përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të investimeve të financuara nga buxheti i njërive të qeverisjes qendrore dhe vendore, të ndërtimeve për qëllime publike në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Përjashtimi i këtyre investimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë përfaqëson një masë fiskale në mbështetje të përmirësimit të kushteve të ofrimit të shërbimeve publike dhe sociale për komunitetin. Duke ulur barrën financiare që kjo taksë ka në koston e financimit të këtyre investimeve, përjashtimi nga kjo taksë synon të ndikojë në një realizim me më pak kosto dhe të shpejtë të investimeve publike.

Për më tej, përjashtimi nga kjo taksë do të çojë në përsheptimin e procedurave administrative për realizimin e këtyre investimeve, duke eliminuar vonesat e mundshme që mund të lindin nga procesi i vlerësimit dhe mbledhjes së kësaj takse, duke nxitur investimet, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin social dhe edukimin e brezave të rinj.

Përsa më lart, ky ndryshim ligjor përfaqëson një instrument për përmirësimin e kapaciteteve dhe kushteve të arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, duke krijuar kushte më të favorshme për investime publike dhe duke mbështetur në mënyrë të qëndrueshme zhvillimin e këtyre shërbimeve në të gjithë vendin.

Ndërkohë, në aspektin financiar, projektligji parashikon të sjellë një ulje të të ardhurave të pushtetit vendor nga taksa e ndikimit në infrastrukturë me rreth 300 milionë lekë, të ardhura të cilat do të kompensohen përmes rritjes së transfertës së pakushtëzuar për qeverisjen vendore, duke filluar nga viti 2026.

Gjithashtu, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i unifikuar dhe i saktë i pikës 2 të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore”*, të ndryshuar, ku përcaktohet se *“...Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave”*, konsiderohet e nevojshme që nëpërmjet këtij projektligji të saktësohet se akti i Këshillit të Ministrave që shërben për këtë qëllim është vendimi i Këshillit të Ministrave që nxirret në mbështetje të neneve 21, pika 2, 22, pika 5, 22/1, 22/3 dhe 22/4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore”*, të ndryshuar.

Ky saktësim është i nevojshëm për shmangien e pasigurive në zbatim dhe interpretim nga institucionet zbatuese të këtij ligji, si dhe parandalimin e praktikave të ndryshme në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, që mund të sjelli trajtim të pabarabartë apo kontestime administrative dhe gjyqësore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është mbështetur në nenet: 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE).

Projektligji *“Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”*, nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (acquis communautaire).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT.

Projektligji përbëhet nga 2 nene:

Në nenin 1, parashikohet se VKM-ja e cila do të përdoret si referencë për çmimet e shitjes gjatë llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, do të jetë e njëjta VKM që del në zbatim të neneve 21, pika 2, 22, pika 5, 22/1, 22/3 dhe 22/4 të këtij ligji. Gjithashtu parashikohet se investimet me fonde buxhetore

të pushtetit qendror dhe vendor, për ndërtimet për qëllime publike në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, përjashtohen nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Në nenin 2, parashikohet hyrja në fuqi e cila është 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe se i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij projektligji, ngarkohet Ministria e Financave dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj parashikohet të sjellë një efekt financiar me rreth 300 milionë lekë në buxhetin e pushtetit vendor, efekt i cili do të kompensohet nëpërmjet rritjes së transfertës së pakushtëzuar për qeverisjen vendore për vitin 2026 dhe në vijim.

MINISTRI
Petrit Malaj